

Vendim nr. 174 datë 22.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Genti Ibrahimimi,	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 22.07.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 8 (T) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: TOM DEDAJ, përfaqësuar nga avokat Gëzim Ceka, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-1974, datë 14.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajftueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi (në cilësinë e paditësit) rezulton se ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kundër Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së

Parë Dibër (palë e paditur), me objekt: *“Dhënien e pagës nga data 01.11.2016 deri në datën 28.01.2018 dhe përqindjes së interesit për vonesat e dhënies së pagës, si edhe dhënien e ditëve të lejes së zakonshme vjetore për vitet 2016-2019.”*

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 4305, datë 18.12.2019, ka vendosur: *“Pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Detyrimin e palës së paditur t’i paguajë paditësit (kërkuesit) përqindjen e interesit për vonesat në dhënien e pagës në masën 62,626.2 lekë dhe lejen e papaguar për vitet 2017-2018 në masën 204,732 lekë. Rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër.”*. Ndaj këtij vendimi ka bërë ankim kërkuesi dhe çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 21.02.2020. Duke qenë se çështja ende nuk është gjykuar nga gjykata e apelit, për shkak të rishortimit disa herë të saj, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e mosmarrëveshjes nga Gjykata Administrative e Apelit.

3. Në këto kushte, Gjykata e Lartë ka kërkuar informacion nga gjyqtarja relatores e çështjes (E.Ç.), sipas së cilës është objektivisht e pamundur shqyrtimi në kohë i kësaj çështjeje dhe kjo nuk mund të përbëjë shkak për shkelje të afatit të arsyeshëm nga gjykata e apelit. Po sipas gjyqtarës relatores, për shqyrtimin e çështjeve, ajo zbaton rendin kronologjik duke iu referuar datës së regjistrimit, ku aktualisht po gjykon çështjet e regjistruara në vitin 2017 dhe se nuk rezulton që nga kërkuesi të jetë kërkuar përsheptimi i gjykimit për shkaqe të arsyeshme.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1974, datë 14.05.2024, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkuesit për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit. Sipas Kolegjit Administrativ, mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit relator. Në këtë rast, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se në rastet kur Gjykata Administrative e Apelit është në kushtet e pamundësisë objektive për shkak të ngarkesës së madhe, Kolegji Administrativ nuk mund t’i kërkojë asaj që të marrë masa për përsheptim të procedurave, kur konstaton se ajo ndjek kritere transparente dhe objektive në përcaktimin e radhës së gjykimit të çështjeve. Në rastin konkret, sipas Kolegjit Administrativ, gjyqtari relator i ka marrë të gjitha masat e nevojshme organizative, duke përcaktuar kritere transparente dhe objektive për marrjen në gjykim të çështjeve sipas radhës së vjetërsisë së çështjeve që i janë ngarkuar në cilësinë e gjyqtarit relator.

5. Në datën 31.05.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të nenit 27 të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 24.06.2024.

II

Pretendimet e kërkuarit

6. **Kërkuari**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor, duke argumentuar se është pezulluar nga puna dhe i është ndërprerë paga padrejtësisht që në vitin 2016, pra afërsisht prej 8 vjetësh, dhe ende çështja e tij nuk ka përfunduar së gjykuari. Sipas kërkuarit, vendimi i Kolegjit Administrativ është me të meta.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitetin e kërkuarit

7. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

8. Për sa i përket legjitimitetit *ratione personae* të kërkuarit, në objektin e kërkesës ai ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-1974, datë 14.05.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, duke i lidhur argumentet me faktin se çështja e tij ka pothuaj 8 vjet që ka nisur dhe ende nuk ka një vendim përfundimtar për të. Për rrjedhojë, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuari legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

9. Një kriter tjetër është edhe ai për *shterimin e mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Gjykata pas ndryshimeve që iu bënë Kodit të Procedurës Civile (KPC)

me ligjin nr. 38/2017, ka mbajtur qëndrimin se nuk mund të investohej drejtpërdrejt për shqyrtimin e kërkesave për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, duke arsyetuar se legjislacioni i brendshëm parashikon tashmë mjete juridike që i ofrojnë individit rezultate konkrete për rivendosjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimet nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 3, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, individi duhet t'u drejtohet gjykatave të zakonshme, në përputhje me parashikimet e KPC-së, dhe vetëm pasi të ketë shteruar garancitë e mbrojtjes që i ofrohen nga juridiksioni i zakonshëm gjyqësor, ai mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues (*shih vendimet nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë në përputhje me nenet 399/1 e vijues të KPC-së për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm të çështjes gjyqësore administrative nr. 31112-00553-86-2020 akti, datë 21.02.2020 të regjistrit themeltar nga Gjykata Administrative e Apelit. Me vendimin nr. 00-2024-1974, datë 14.05.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, për rrjedhojë kërkuesi e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i ligjit nr. 8577/2000.

11. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi jo vetëm që shkelja është vazhduese, por edhe vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë që ka shqyrtuar kërkesën për konstatimin e cenimit dhe përshpejtimin e procedurave, mban datën 14.05.2024, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 31.05.2024 (sipas shënimit të shërbimit postar), pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i ligjit nr. 8577/2000.

12. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, edhe pse kërkuesi nuk e ka parashtruar në objektin e ankimit kushtetues individual, në thelb, ai ka ngritur pretendime për kohëzgjatjen e shqyrtimit të çështjes së tij të regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit, për të cilën ende nuk ka një vendimmarrje dhe as një datë të planifikuar për shqyrtimin e saj. Për rrjedhojë, pretendimet e tij do të vlerësohen në këndvështrim të kohëzgjatjes së procesit gjyqësor të kundërshtuar, të cilat, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

13. Sipas kërkuetit, ai është pezulluar nga puna dhe i është ndërprerë paga padrejtësisht që në vitin 2016, pra afërsisht prej 8 vjetësh, dhe ende çështja e tij nuk ka

përfunduar së gjykuari. Gjithashtu, kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Kolegjit Administrativ që ka shqyrtuar kërkesën e tij për konstatimin e cenimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit është me të meta.

14. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, kushdo, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në momentin kur jepet vendimi dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi me objekt dhënien e pagës nga data 01.11.2016 deri në datën 28.01.2018 dhe përqindjes së interesit për vonesat e dhënies së pagës, si edhe dhënien e ditëve të lejes së zakonshme vjetore për vitet 2016-2019. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, vendim i cili është ankimuar nga kërkuesi. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 21.02.2020, pra aktualisht kanë kaluar 4 vjet e 5 muaj dhe ende nuk ka një vendimarrje në lidhje me themelin e saj.

16. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, Gjykata ka theksuar se neni 48 i ligjit nr. 49, datë 30.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit, ndërsa KPC-ja, me ndryshimet e vitit 2017, në grupin e rregullave për mjetet e ankimit për konstatimin e shkeljeve të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka përcaktuar afatin 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë (neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së). Kjo nënkupton se formalisht gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit ka tejkaluar afatin e përcaktuar ligjor.

17. Në këtë drejtim, paraprakisht, Gjykata ka theksuar se, sikurse tashmë ka konstatuar gjatë gjykimit të çështjeve që lidhen me kohëzgjatjen e paarsyeshme të afatit në parim, vonesa në gjykimin e çështjeve të individëve është pasojë e ngarkesës së lartë në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se pavarësisht rëndësisë dhe përfitimeve që sjellin reformat në sektorin e drejtësisë, ligjvënësi ka për detyrë të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike, me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht.

Gjithsesi, kjo gjendje është duke u zgjatur prej disa vitesh, prandaj edhe metodat e identifikuar nga vetë gjykatat dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, në cilësinë e organit kushtetues që ka përgjegjësinë për të siguruar mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor (*neni 147, pika 1, i Kushtetutës*), tregojnë se mekanizmat e parashikuar nga nenet 399/1-399/12 të KPC-së i shërbejnë një kohe normale të veprimtarisë gjyqësore, pra jo situatës së jashtëzakonshme, në pikëpamje të volumit, që ndodhet tashmë sistemi i drejtësisë (*shih vendimet nr. 37, datë 07.05.2024; nr. 21, datë 04.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në këto kushte, për të vlerësuar nëse në rastin në shqyrtim ka pasur tejzgjatje të paarsyeshme të afatit, pra nëse kërkuesit i është cenuar e drejta kushtetuese e procesit të rregullt në këtë aspekt, në vijim do të analizohen rrethanat e veçanta të çështjes konkrete dhe kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese që lidhen me: (i) sjelljen e kërkuesit; (ii) kompleksitetin e çështjes; (iii) sjelljen e autoriteteve; (iv) rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuesi (*shih vendimet nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me *sjelljen e kërkuesit*, referuar akteve të ardhura me kërkesën, Kolegji vëren se ai, në datën 18.04.2024, pas kalimit të afatit 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në shkallë të dytë, sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “a”, të KPC-së, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Në lidhje me këtë kërkesë, Gjykata e Lartë ka vendosur rrëzimin e saj. Sikurse pranohet edhe nga Gjykata e Lartë, nuk konstatohet ndonjë sjellje e palëve që të ketë ndikuar në kohëzgjatjen e procesit, për sa kohë që nga regjistrimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit e deri në momentin e marrjes në shqyrtim të kërkesës për konstatimin dhe përshpejtimin e gjykimit për çështjen e kërkuesit nuk është kryer asnjë veprim procedural. Në këtë kuptim, nuk duket që sjellja e kërkuesit të jetë bërë shkak për tejzgjatjen e gjykimit të çështjes së tij.

20. Për sa i takon *kompleksitetin të çështjes*, Kolegji konstaton se çështja ka natyrë administrative me të paditur Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, me disa kërkime në objektin e padisë, të cilat, në thelb, lidhen me dhënien e pagës dhe interesat për vonesat në dhënien e saj. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, ndërsa Gjykata Administrative e Apelit është vënë në lëvizje mbi ankimin e kërkuesit. Ashtu siç thekson edhe Gjykata e Lartë në vendimin për rrëzimin e kërkesës për konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit të çështjes dhe përshpejtimin, çështja nuk paraqitet komplekse.

21. Për sa i përket *sjelljes së autoriteteve*, duke mbajtur në konsideratë për sa është theksuar më sipër për situatën aktuale të ngarkesës së sistemit gjyqësor (*shih paragrafin 17 të*

vendimit), Kolegji vëren se çështja e kërkuarit është në pritje për shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit tashmë prej 4 vjetësh e 5 muajsh, ndërsa kohëzgjatja totale e procedurave nga momenti i paraqitjes së padisë në gjykatën e shkallës së parë është pothuajse 5 vjet. Nga të dhënat e marra nga Gjykata Administrative e Apelit (*shih paragrafin 4 të vendimit*), sikurse arsyeton dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin për rrëzimin e kërkesës së tij për konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit dhe përshpejtimin e procedurave, gjykata e apelit është në pamundësi objektive për të gjykuar çështjen e kërkuarit brenda afatit të arsyeshëm, për shkak të ngarkesës së madhe dhe jo për shkaqe që lidhen me Gjykatën Administrative të Apelit. Prandaj, në analizë të të dhënave të mësipërme, Kolegji evidenton se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes së kërkuarit lidhet me ngarkesën e lartë në Gjykatën Administrative të Apelit dhe të gjyqtarit relator, shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi.

22. Së fundmi, në lidhje me *rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuari*, Kolegji konstaton se çështja e tij, për shkak të natyrës së saj, nuk lidhet me interesa “vetjakë e jetësorë”, duke qenë se pretendimet e kërkuarit kanë të bëjnë me shkeljet që sipas tij janë zhvilluar nga gjykatat, si edhe duke qenë se gjykata e shkallës së parë ka vendosur detyrimin e palës së paditur t’i paguajë kërkuarit “përqindjen e interesit” për vonesat në dhënien e pagës dhe lejen e papaguar për vitet 2017-2018. Duke mbajtur në konsideratë edhe kohën prej 4 vjetësh e 5 muajsh për shqyrtimin e çështjes në raport me ngarkesën me të cilën përballet sistemi i drejtësisë, konstatohet se kjo çështje nuk rezulton të jetë e tillë që për shkak të natyrës së saj të ketë përparësi në radhën e shqyrtimit. Po kështu, kërkuari, pavarësisht se ka barrën e provës në këtë drejtim, nuk ka paraqitur ndonjë argument se vonesa në shqyrtimin e çështjes i ka sjellë pasoja të menjëhershme, jetike dhe ngushtësisht personale për t’i dhënë prioritet gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka parashikuar listën e çështjeve të cilat kërkojnë “kujdes të veçantë” ose “kujdes të jashtëzakonshëm”, të tilla, si ato që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj.

23. Nisur nga sa më lart, duke vlerësuar së bashku përfundimet e analizës të secilit prej standardeve të lartpërmendura kushtetuese, Kolegji evidenton se në rrethanat e rastit konkret, pavarësisht se formalisht afatet ligjore nuk janë respektuar, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes së kërkuarit në Gjykatën Administrative të Apelit në raport me situatën aktuale të ngarkesës në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, si dhe me rëndësinë e asaj çfarë rrezikon ai, nuk duket të ketë tejkaluar një kufi kohor të paarsyeshëm në aspektin kushtetues, prandaj kërkesa nuk është e bazuar.

24. Si përfundim, bazuar në të gjithë arsyetimin e mësipërm, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk i plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.